



UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS / AGRICULTURAL UNIVERSITY OF TIRANA

Rr. Pajsi Vodica, Kodër-Kamëz, Tiranë, Albania. / T: +35547200874 / E: info@ubt.edu.al / W: www.ubt.edu.al

At. 3060/1 Dot
Dt. 25.10.2024

MIRATOHET

Kryetari i Senatit Akademik

Prof. Dr. Fatbardh SALLAKU



RREGULLORE

**PËR FITIMIN E TITUJVE AKADEMIKË
NË UNIVERSITETIN BUJQËSOR TË TIRANËS**

Tiranë 2024

KREU 1

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti dhe qëllimi i rregullores

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe procedurave të detajuara, si dhe standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor” në Universitetin Bujqësor të Tiranës, në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Rregullorja ka për qëllim të përcaktojë procedurat dhe rregullat që zbatohen nga subjektet pjesëmarrëse në procesin për fitimin e titujve akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor”, të drejtat e detyrimit e personelit akademik dhe organeve përgjegjëse për promovimin akademik, si dhe raportet me organet dhe autoritetet përgjegjëse për promovimin akademik.

Neni 2

Baza ligjore

Rregullorja për fitimin e titujve akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor” në UBT, mbështetet në nenin 57 pika 7 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM-në nr. 112, datë 23.02.2018 “Për Përcaktimin e Kritereve për Fitimin e Gradës Shkencore “Doktor” dhe të Standardeve Shtetërore për Fitimin e Titujve Akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor”, (i përditësuar) ndryshuar me VKM nr. 808, datë 11.12.2019; VKM nr. 128, datë 06.03.2024; Statutin e UBT-së, miratuar me urdhrin nr. 279, datë 28.07.2021 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Kodin e Etikës së Universitetit Bujqësor të Tiranës.



KREU II

STANDARTET

PËR FITIMIN E TITULLIT AKADEMIK “PROFESOR I ASOCIUAR”

Neni 3

Përvoja akademike

1. Titulli “*Profesor i asociuar*” jepet nga Universiteti Bujqësor i Tiranës, përcaktuar nga Ligji i Arsimit të Lartë 80/2015, sipas neneve 60 dhe 61 dhe mbështetur në VKM-në nr. 112, datë 23.02.2018 “*Për Përcaktimin e Kriteve për Fitimin e Gradës Shkencore “Doktor” dhe të Standardeve Shtetërore për Fitimin e Titujve Akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor”, (i përditësuar)*”
2. Për fitimin e titullit akademik “Profesor i asociuar” mund të aplikojë personeli akademik i kategorisë “Lektor”, i cili ka mbrojtuar gradën shkencore “Doktor” të paktën 5 (pesë) vjet nga data e aplikimit për fitimin e titullit të mësipërm.
3. Personeli akademik me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, që aplikon për titullin akademik “Profesor i asociuar”, duhet:
 - a. të ketë zhvilluar një cikël leksionesh për së paku një lëndë, për 3 (tri) vite akademike;
 - b. të ketë përvojë pune si personel akademik me kohë të plotë për një periudhë, së paku, 5 (pesë)-vjeçare, me apo pa ndërprerje ose me kohë të pjesshme si lektor, për një periudhë 8 (tetë)-vjeçare akademike, me apo pa ndërprerje. Personeli akademik që ka përvojë akademike me kohë të plotë më të ulët se pesë vite, por ka përvojë pune si personel akademik me kohë të pjesshme më të ulët se 8 (tetë) vite, koha e pjesshme i konvertohet si vite me kohë të plotë, e cila përllogaritet me një koeficient prej 1.6 vite kohë e pjesshme, e konvertuar në 1 (një) vit përvojë pune me kohë të plotë, pas fitimit të gradës shkencore “Doktor”.
 - c. të jetë i aftë të mbajë para jurisë ligjërata në një nga pesë gjuhët e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian: angleze, frënge, gjermane, italiane ose spanjolle.
 - ç. të paraqesë dokumentin që verteton kontrollin antiplagjiaturë.

Neni 4

Botimet e realizuara nga personeli akademik

1. Personeli akademik, që aplikon për titullin “Profesor i asociuar”, duhet të shfaqë zotërim të plotë të fushës së tij kërkimore, e cila reflektohet në realizimin e detyrimeve të mëposhtme:
 - a. ka botuar, së paku, 5 (pesë) artikuj shkencorë në revista shkencore brenda vendit ose ndërkombëtare të indeksuara. Së paku, 2 (dy) prej artikujve të jenë



- botuar në revista ndërkombëtare të indeksuara në *Scopus*, me indikatorë citimi, *CiteScore* ose *SCImago Journal Rank* (SJR) dhe/ose *Web of Science* me indikatorë citimi të *Journal Citation Report* (JCR), faktor impakti IF ose *Journal Citation Indicator* (JCI)”. Kur këta artikuj janë në bashkautorësi, kandidati duhet të jetë autori i parë, ose i dytë. Kandidati duhet të jetë autor i vetëm ose i parë në, të paktën, 2 (dy) artikuj shkencorë të paraqitur për fitimin e titullit.
- b. ka realizuar si autor i parë, së paku 5 (pesë) referime, nga të cilat, së paku, 2 (dy) janë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “Proceedings”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.
2. Kur kandidati paraqet monografi, e cila përmbush kriteret e mëposhtme, ai përjashtohet nga detyrimet e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1 të nenit 4, sipas ekuivalentimit që vijon:
- a. botimi i 1 (një) monografie shkencore, e botuar pas fitimit të gradës shkencore “Doktor”, brenda ose jashtë vendit, e cila duhet të përmbushë kushtet e origjinalitetit dhe duhet të jetë vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga të paktën 2 (dy) vlerësues të pavarur të fushës kërkimore shkencore, dhe të jetë pranuar nga njësia bazë, që mbulon fushën e kërkimit;
- b. monografia shkencore e botuar jashtë vendit konsiderohet e vlefshme nëse shtëpia botuese është e rankuar nga SENSE Ranking of Academic Publishers, në kategorinë A, B, C ose D. Monografitë konsiderohen të ndryshme ndërmjet tyre kur ndryshojnë në përmbajtje me të paktën, 70 %. Monografia e botuar brenda vendit duhet të jetë e vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga të paktën 2 (dy) “Profesorë” të fushës kërkimore-shkencore, nga të cilët, të paktën njëri prej tyre duhet të jetë nga vendet anëtare të BE-së, OECD-së ose G20-ës.

Monografia e botuar brenda vendit ekuivalentohet me:

- i. 2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit;
- ii. 1 (një) artikull shkencor që është botuar në revistë ndërkombëtare, e indeksuar në një nga databazat e të dhënave të revistave shkencore të njohura ndërkombëtarisht, si *Scopus*, me indikatorë citimi, *CiteScore* ose *SCImago Journal Rank* (SJR) dhe/ose *Web of Science* me indikatorë citimit të *Journal Citation Report* (JCR), faktor impakti IF ose *Journal Citation Indicator* (JCI)”.

Monografia e botuar jashtë vendit ekuivalentohet me:

- i. 4 (katër) artikuj shkencore, të botuar në revistë shkencore brenda vendit;



- ii. 2 (dy) artikuj shkencorë që janë botuar në revistë ndërkombëtare, e indeksuar në një nga databazat e të dhënave të revistave shkencore të njohura ndërkombëtarisht, si *Scopus*, me indikatorë citimi, *CiteScore* ose *SCImago Journal Rank* (SJR) dhe/ose *Web of Science* me indikatorë citimit të *Journal Citation Report* (JCR), faktor impakti IF ose *Journal Citation Indicator* (JCI)”.

Neni 5

Promovimi akademik në bazë të angazhimit dhe pjesëmarrjes në veprimtari të tjera akademike

1. Për efekt të promovimit akademik, merret në konsideratë angazhimi dhe pjesëmarrja e kandidatit, pas fitimit të gradës shkencore “Doktor”. Këto veprimtari ekuivalente të kandidatit nuk e përjashtojnë atë nga detyrimet/kriteret e përcaktuara në Nenet 3 dhe 4 të këtij kreu.
 - a. komitete shkencore ose redaktuese;
 - b. veprimtari vlerësuese si anëtar komiteti shkencor apo redaktues për llogari të periodikëve ose joperiodikëve shkencorë;
 - c. projekte kërkimore-shkencore në nivel drejtuesi, koordinatori ose anëtar;
 - d. përfitimin e financimeve me bazë konkurrimi në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
 - e. projekte të financuar nga programe me donator të huaj, të cilat sjellin përfitime për institucionin, në rolin e koordinatorit të projektit;
 - f. vlerësimet e projekteve kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare;
 - g. si drejtues në komitetet organizuese të konferencave shkencore kombëtare ose ndërkombëtare;
 - h. projektet e transferimit teknologjik të patentave.

Neni 6

Ekuivalentimi në bazë të angazhimit dhe pjesëmarrjes në veprimtari të tjera

1. Angazhimi dhe pjesëmarrja e kandidatit në së paku 4 (katër) veprimtari të përcaktuara në nenin 5, mund të ekuivalentohet me:
 - a. 1 (një) artikull shkencor që është botuar në revistë ndërkombëtare, e indeksuar në një nga databazat e të dhënave të revistave shkencore të njohura ndërkombëtarisht, si *Scopus*, me indikatorë citimi, *CiteScore* ose *SCImago Journal Rank* (SJR) dhe/ose *Web of Science* me indikatorë citimit të *Journal Citation Report* (JCR), faktor impakti IF ose *Journal Citation Indicator* (JCI)”.



- b. 1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit dhe 2 (dy) referime mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “Proceedings”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.
2. Raporti për angazhimin dhe pjesëmarrjen për veprimtaritë e parashikuara në nenin 9, hartohet nga njësia bazë dhe pas konfirmimit nga Drejtoria e Shkencës dhe Promovimit Akademik, miratohet nga Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik (KPPA).

Neni 7

Realizimi i studimit postdoktoratë në një nga vendet anëtare të BE-së

1. Në rastet kur kandidati ka realizuar studim postdoktoratë në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, me një kohëzgjatje, të paktën, 6 (gjashtë) muaj, shoqëruar me raport të detajuar për aktivitetin kërkimor-shkencor të zhvilluar gjatë kësaj periudhe, ai ekuivalentohet me:
 - a. 1 (një) artikull shkencor të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti;
 - b. 1 (një) referim të mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “Proceedings”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

Neni 8

Vlefshmëria e botimeve shkencore për fitimin e titullit akademik “Profesor i asociuar”

Për fitimin e titullit akademik “Profesor i asociuar”, botimet shkencore të vlefshme janë ato të realizuara pas mbrojtjes së gradës shkencore “doktor”, deri në datën e dorëzimit të dosjes së aplikimit për titullin akademik “Profesor i asociuar”.

Kandidati duhet të ketë aftësi të larta didaktike në marrëdhënie me studentët dhe auditorin dhe ta vërtetojë atë nëpërmjet një prezantimi (leksion) të hapur për gjetje kërkimore që janë produkt i një studimi/projekti para Jurisë si dhe një prezantim lidhur me veprimtarinë e tij akademike dhe kërkimore para Komisionit (KPPA) në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Evropian: angleze, frënge, gjermane, italiane, ose spanjolle.



KREU III
STANDARTET
PËR FITIMIN E TITULLIT AKADEMIK “PROFESOR”

Neni 9

Përvoja akademike

1. Titulli akademik “Profesor” jepet nga Universiteti Bujqësor i Tiranës, përcaktuar në ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015, sipas neneve 60 dhe 61 dhe Standartet e VKM-së nr. 112, datë 23.02.2018 *“Për Përcaktimin e Kritereve për Fitimin e Gradës Shkencore “Doktor” dhe të Standardeve Shtetërore për Fitimin e Titujve Akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor”, (i përditësuar)*
2. Për fitimin e titullit akademik “Profesor” mund të aplikojë personeli akademik, i cili ka titullin akademik “Profesor i asociuar”. Personeli akademik, i cili ka titullin akademik “Profesor i asociuar” aplikon për fitimin e titullit akademik “Profesor”, të paktën, 5 (pesë) vite pas fitimit të titullit akademik “Profesor i asociuar”.
3. Personeli akademik me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, që aplikon për titullin akademik “Profesor”, duhet:
 - a. të ketë qenë titullar lënde ose moduli dhe udhëheqës i veprimtarisë shkencore për një periudhë jo më të shkurtër se 5 (pesë) vite akademike;
 - b. të jetë ose të ketë qenë i punësuar si personel akademik me kohë të plotë për një periudhë 8 (tetë)-vjeçare akademike, pas fitimit të gradës shkencore “Doktor”, ose me kohë të pjesshme, për një periudhë 12 (dymbëdhjetë)-vjeçare akademike pas fitimit të gradës shkencore “Doktor”.

Personeli akademik që ka përvojë akademike me kohë të plotë më të ulët se 8 (tetë) vite, por ka përvojë pune si personel akademik me kohë të pjesshme më të ulët se 12 (dymbëdhjetë) vite, koha e pjesshme i konvertohet si vite me kohë të plotë, e cila përllogaritet me një koeficient prej 1.5 vitesh kohë e pjesshme, e konvertuar në 1 (një) vit përvojë pune me kohë të plotë, pas fitimit të gradës shkencore “Doktor”.
 - c. Si rregull, të ketë udhëhequr ose bashkëudhëhequr, të paktën 2 (dy) doktorata. Bashkudhëheqja duhet të jetë me personel akademik të kategorisë “Profesor”, me IAL brenda ose jashtë vendit, në bazë të një marrëveshjeje dypalëshe. Në rast se kandidati ushtron veprimtarinë e tij akademike shkencore pranë një njësie kryesore me më pak se 40 (dyzet) veta personel akademik me kohë të plotë, duhet të ketë udhëhequr/bashkudhëhequr, të paktën, 1 (një) doktoratë të përfunduar, ndërsa kriteri për udhëheqjen e doktoratës tjetër konsiderohet i plotësuar nëse kandidati është angazhuar në mësimdhënie në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të paktën për një periudhë prej 6 (gjashtë) muajsh pa ndërprerje ose 1 (një) vit me ndërprerje, në tri vitet e fundit”.



- d. të jetë i aftë të mbajë ligjërata në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Evropian: angleze, frënge, gjermane, italiane, spanjolle përpara Jurisë dhe KPPA-së në një nga gjuhët e mësipërme, në përputhje kjo me Statutin dhe Rregulloren e Studimeve të UBT-së.
- e. të paraqesë dokumentin që verteton kontrollin antiplagjiaturë.

Neni 10

Botimet e realizuara nga personeli akademik

1. Personeli akademik, i cili aplikon për titullin “Profesor”, duhet të shfaqë zotërim të plotë të fushës së tij kërkimore, e cila reflektohet në realizmin e detyrimeve, si më poshtë vijon:
 - a. Ka botuar, së paku, 7 (shtatë) artikuj shkencorë në revista shkencore brenda vendit ose ndërkombëtare të indeksuara. Së paku, 3 (tre) prej artikujve të jenë botuar në revista ndërkombëtare të indeksuara në një nga databazat e të dhënave të revistave shkencore të njohura ndërkombëtarisht, si Scopus, me indikatorë citimi, *CiteScore* ose *SCImago Journal Rank* (SJR) dhe/ose *Web of Science* me indikatorë citimit të *Journal Citation Report* (JCR), faktor impakti IF ose *Journal Citation Indicator* (JCI).” Kur këta artikuj janë në bashkëautorësi, kandidati duhet të jetë autor i parë ose i dytë. Kandidati duhet të jetë autor i parë në të paktën 4 (katër) artikuj shkencorë të paraqitur për fitimin e titullit.
 - b. Ka realizuar si autor i parë, së paku, 5 (pesë) referime, nga të cilat, së paku 2 (dy) janë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “Proceedings”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.
2. Kur kandidati paraqet monografi, e cila përmbush kriteret e mëposhtme, ai përjashtohet nga detyrimet e përcaktuara në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 10, sipas ekuivalentimit që vijon:
 - a. botimi i 1 (një) monografie shkencore, e botuar pas fitimit të gradës shkencore “Profesor i asociuar” brenda ose jashtë vendit, e cila duhet të përmbushë kushtet e origjinalitetit dhe duhet të jetë vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) vlerësues të pavarur të fushës kërkimore-shkencore, dhe të jetë pranuar nga njësia bazë, që mbulon fushën e kërkimit. Monografia shkencore e botuar jashtë vendit konsiderohet e vlefshme nëse shtëpia botuese është e rankuar nga SENSE Ranking of Academic Publishers, në kategorinë A, B, C ose D. Monografite konsiderohen të ndryshme ndërmjet tyre kur ndryshojnë në përmbajtje me, të paktën, 70%. Monografia e botuar brenda vendit duhet të jetë e vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) “Profesorë” të fushës kërkimore-shkencore, nga të cilët, të paktën njëri prej tyre duhet të jetë nga vendet e BE-së, OECD-së ose G20-ës.
 - b. monografia e botuar brenda vendit ekuivalentohet me:



- i. 2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit;
 - ii. 1 (një) artikull shkencor që është botuar në revistë ndërkombëtare, e indeksuar në një nga databazat e të dhënave të revistave shkencore të njohura ndërkombëtarisht, si *Scopus*, me indikatorë citimi, *CiteScore* ose *SCImago Journal Rank* (SJR) dhe/ose *Web of Science* me indikatorë citimit të *Journal Citation Report* (JCR), faktor impakti IF ose *Journal Citation Indicator* (JCI).”
 - c. monografia e botuar jashtë vendit ekuivalentohet me:
 - i. 4 (katër) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit;
 - ii. 2(dy) artikuj shkencorë që janë botuar në revistë ndërkombëtare, e indeksuar në një nga databazat e të dhënave të revistave shkencore të njohura ndërkombëtarisht, si *Scopus*, me indikatorë citimi, *CiteScore* ose *SCImago Journal Rank* (SJR) dhe/ose *Web of Science* me indikatorë citimit të *Journal Citation Report* (JCR), faktor impakti IF ose *Journal Citation Indicator* (JCI).”
3. Kandidati duhet të ketë aftësi të larta didaktike në marrëdhënie me studentët dhe auditorin dhe ta vërtetojë atë nëpërmjet një prezantimi (leksion) për gjetjet kërkimore që janë produkt i një studimi/projekti para Jurisë dhe një prezantim të tij para Komisionit (KPPA), lidhur me veprimtarinë e tij akademike dhe kërkimore në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Evropian: angleze, frënge, gjermane, italiane, ose spanjolle.

Neni 11

Promovimi akademik në bazë të angazhimit të pjesëmarrjes në veprimtari akademike

Për efekt të promovimit akademik, merret në konsideratë angazhimi dhe pjesëmarrja e kandidatit, pas fitimit të titullit akademik “Profesor i asociuar”. Veprimtaritë ekuivalente të kandidatit në seksionin më poshtë, nuk e përjashtojnë atë nga detyrimet e përcaktuara në Nenin 10, shkronjat 1a dhe 1b, sipas ekuivalentimit që vijon:

- a. komitete shkencore apo redaktuese;
- b. veprimtari vlerësuese si anëtar komiteti shkencor apo redaktues, për llogari të periodikëve ose joperiodikëve shkencorë;
- c. projekte kërkimore-shkencore në nivel drejtuesi, koordinatori ose anëtar;
- d. përfitimin e financimeve me bazë konkurrimi në nivel kombëtar e ndërkombëtar;
- e. projekte të financuara nga programe me donatorë të huaj, të cilat sjellin përfitime për institucionin, në rolin e koordinatorit të projektit;
- f. vlerësimet e projekteve kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare;
- g. si drejtues në komitetet organizuese të konferencave shkencore kombëtare ose ndërkombëtare;



- h. projektet e transferimit teknologjik të patentave.

Neni 12

Ekuivalentimi në bazë të angazhimit dhe pjesëmarrjes në veprimtari

1. Angazhimi dhe pjesëmarrja e kandidatit në një ose disa veprimtari të përcaktuara në nenin 11, të këtij kreu, mund të ekuivalentohet me:
 - a. 1(një) artikull shkencor që është botuar në revistë ndërkombëtare, e indeksuar në një nga databazat e të dhënave të revistave shkencore të njohura ndërkombëtarisht, si Scopus, me indikatorë citimi, *CiteScore* ose *SCImago Journal Rank* (SJR) dhe/ose *Web of Science* me indikatorë citimit të *Journal Citation Report* (JCR), faktor impakti IF ose *Journal Citation Indicator* (JCI);”.
2. Pavarësisht numrit të lartë të angazhimit dhe pjesëmarrjes së kandidatit në veprimtari shkencore, nuk mund të bëhet më shumë se 1 (një) ekuivalentim sipas përcaktimeve të bëra në pikën 1/a/b të këtij neni.
3. Raporti për angazhimin dhe pjesëmarrjen për veprimtaritë e parashikuara në nenin 11, hartohet nga njësia bazë dhe njësia kryesore dhe pas konfirmimit nga Drejtoria e Shkencës dhe Promovimit Akademik të UBT-së, miratohet nga Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik (KPPA).

Neni 13

Vlefshmëria e botimeve shkencore për fitimin e titullit akademik “Profesor”

Për fitimin e titullit akademik “Profesor”, botimet shkencore të vlefshme janë ato të realizuara pas mbrojtjes së titullit akademik “Profesor i asociuar” deri në datën e dorëzimit të dosjes së aplikimit për titullin akademik “Profesor”.

KREU IV

PROCEDURAT PËR FITIMIN E TITUJVE AKADEMIKË

Neni 14

Paraqitja e kërkesës dhe dosjes për aplikim

1. Kandidati paraqet kërkesën dhe dosjen pranë drejtuesit të njësisë kryesore, i cili ia përcjell për vlerësim njësisë bazë brenda 20 (njëzet) ditëve.
2. Pas vlerësimit nga njësia bazë, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve, dosja e kandidatit përmes drejtuesit të njësisë kryesore përkatëse i përcillet me shkresë përcjellëse, Drejtorisë së Shkencës dhe Promovimit Akademik (DSHPA) e cila bën konfirmimin dhe ballafaqimin me



kërkesat ligjore. Në rast të evidentimit të mangësive në dosjen e kandidatit, DSHPA i jep atij/asaj 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kohë për të bërë plotësimet e nevojshme. Në rast se ato nuk plotësohen, dosja i kthehet kandidatit.

3. Nëse njësia bazë jep vlerësim negativ, dosja i kthehet drejtuesit të njësisë kryesore me argumentet dhe sugjerimet përkatëse.
4. Kandidati ka të drejtë të aplikojë sërish, brenda një afati kohor prej 6 (gjashtë) muajsh.
5. Vendimi i njësisë bazë merret nga shumica e anëtarëve të saj.

Neni 15

Paraqitja e kërkesës dhe dosjes për aplikim për personelin jashtë Universitetit Bujqësor të Tiranës

Të gjithë kandidatët që nuk janë me marrëdhënie kontraktuale me Universitetin Bujqësor të Tiranës por që plotësojnë kërkesat ligjore për promovim për tituj akademikë dhe kërkojnë të promovohen në Universitetin Bujqësor të Tiranës, i paraqesin Rektoratit të UBT-së dosjen e plotë, sipas rregullores së Promovimit të titujve akademikë të UBT-së, së bashku me një kërkesë për shqyrtimin e dosjes nga kandidati, si dhe një shkresë përcjellëse, të mirë argumentuar, nga titullari i IAL nga vjen kandidati.

Neni 16

Shqyrtimi i dosjes dhe procedura e vlerësimit

Pas dorëzimit të dosjes në UBT, ajo shqyrtohet nga Drejtoria e Shkencës dhe Promovimit Akademik për:

1. Përputhshmërinë e Diplomave të Studimeve Universitare, Master dhe Doktoratë me programet e studimit të ofruara nga Universiteti Bujqësor i Tiranës.
2. Dosja pranohet për vazhdimin e procedurës më tej për të gjithë kandidatët nga jashtë universitetit, të cilët rezultojnë që kanë mbaruar studimet e tre cikleve në UBT, ose kanë kryer studime që janë të ngjashëm me to.
3. Dosja refuzohet kur kandidati:
 - a. nuk ka mbaruar programe studimi në UBT, por në një nga universitetet që ka kapacitete për dhënien e titujve akademikë;
 - b. kandidati ka mbaruar programe studimi në universitete të cilat nuk gëzojnë të drejtën e promovimit të titujve akademikë, por programet e studimit të tyre janë jashtë profilit të programeve të UBT-së;
 - c. nuk ka përputhshmëri në profilin/drejtimin shkencor/fushën e kërkimit të kërkuar nga kandidati me njësitë/grupet e kërkimit dhe mësimi që zhvillojnë aktivitete kërkimor mësimor në UBT.



- d. në Universitetin Bujqësor të Tiranës nuk ka njësi bazë ose GMK që të ketë kapacitete të mjaftueshme të gjykojë, me kompetencë të plotë akademike, aktivitetin shkencor të kandidatit;
 - e. dosja e kandidatit ka mungesa në dokumentacion.
4. Në rast se pas shqyrtimit, dosja e kandidatit është konform kushteve më lart, Rektori e dërgon atë për vazhdimin e procedurës tek Dekani i Fakultetit. Në të gjitha rastet e tjera, dosja refuzohet dhe i kthehet mbrapsht kandidatit;
5. Procedura e aplikimit nis pasi kandidati ka bërë pagesën sipas përcaktimeve të bëra nga UBT.
6. Dekani i Fakultetit e shqyrton dosjen e dërguar nga Rektori, në jo më shumë se 20 ditë punë nga data e dërgimit, nëpërmjet zyrës së zv/Dekanit për titujt akademikë dhe gradat shkencore, bën ballafaqimin e dokumentacionit me kërkesat e mësipërme dhe në bazë të afinitetit dhe fushës së kërkimit të kandidatit e dërgon për vazhdimin e procedurës tek departamenti respektiv. Pas marrjes së dosjes nga dekani, procedura në departament ndiqet e njëjtë si për vlerësimin dhe promovimin e titujve akademikë të stafit akademik të brendshëm.

Neni 17

Ngritja e jurisë për vlerësimin e dosjes

Në rast se dosja konsiderohet e plotë nga njësia bazë, ajo i përcillet Drejtorisë së Shkencës dhe Promovimit Akademik e cila e përcjell dosjen e plotë pranë Rektorit së bashku me propozimin për përbërjen e Jurisë. Pas verifikimit të dokumentacionit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e dosjes, procedura i përcillet Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik, në bazë të skedës tip të përgatitur për këtë qëllim.

- 1. Anëtarët e jurisë së miratuar në njësine bazë, propozohen nga drejtuesi i njësies kryesore dhe pas miratimit nga Rektori, brenda 10 (dhjetë) ditëve bashkë me dosjen e kandidatit i dërgohen Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik (KPPA).
- 2. Numri i anëtarëve të propozuar është jo më pak se 8 (tetë). Anëtarët e propozuar duhet të kenë shprehur paraprakisht dakortësinë (me email zyrtar ose shkresë të firmosur) për pjesëmarrjen në Juri dhe propozimi i tyre duhet të shoqërohet me një CV të shkurtër.
- 3. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas përcjelljes së dosjes nga Senati, Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik (KPPA) vlerëson nëse dosja e dorëzuar nga kandidati përmban ose jo dokumentacionin përkatës. Pas shqyrtimit të dosjes si dhe shqyrtimit të saj nga Juri, caktohet një relator për të bërë një përmbledhje para komisionit. Relatori si rregull është anëtar i njësies kryesore ku ka dorëzuar dosjen kandidati që kërkon titullin akademik. Çdo anëtar i komisionit ka përgjegjësi ligjore në process. Kjo nuk përjashton përgjegjësinë individuale të anëtarëve të KPPA-së.
- 4. Në rast se dosja konsiderohet e plotë, Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik vijon menjëherë me ngritjen e jurisë për vlerësimin e dosjes.




5. Në rast të evidentimit të mangësive në dosjen e kandidatit, atij/asaj i jepen 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kohë për të bërë plotësimet e nevojshme. Në rast se ato nuk plotësohen, dosja i kthehet kandidatit.
6. Juria përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë me titullin akademik “Profesor” (me kontratë të përhershme ose që kanë fituar titullin “Profesor Emeritus”) të së njëjtës fushë ose fushave të ngjashme me atë të kandidatit, prej të cilëve, të paktën, 2 (dy) duhet të jenë të ftuar nga institucione të tjera të arsimit të lartë, vendase ose të huaja, ose personalitete të spikatur të fushës.

Neni 18 **Procedura e vlerësimit**

1. Data e nisjes së procedurës së vlerësimit të kandidatit konsiderohet data e ngritjes së jurisë.
2. Brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve Juria fillon procedurën e vlerësimit, ku kandidatit i caktohet të zhvillojë 1 (një) prezantim (leksion) të hapur për gjetjet kërkimore të një studimi/projekti para Jurisë së ngritur.
3. Juria shqyrton dosjen e kandidatit, përgatit dhe miraton raportin e vlerësimit të kapaciteteve akademiko-didaktike e shkencore të kandidatit. Në përfundim jepet rekomandimi për dhënien ose jo të titullit akademik. Raporti i vlerësimit i përcillet Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik (KPPA).
4. Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik (KPPA), pasi vlerëson dosjen dhe Raportin e Jurisë, dëgjon një prezantim të kandidatit lidhur me veprimtarinë e tij akademike dhe kërkimore, në një nga pesë gjuhët perëndimore, të përcaktuara në Nenin 10, pika 3.
5. Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik (KPPA) me votim të hapur merr vendimin përfundimtar me shumicën e anëtarëve të tij, për miratimin ose refuzimin e kërkesës së kandidatit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas marrjes së raportit të vlerësimit nga juria. Votimi i fshehtë bëhet për raste të veçanta kur kërkohet nga të paktën 4 anëtarë të komisionit.
6. Vendimi i KPPA-së i përcillet Rektorit të UBT-së, i cili vazhdon procedurën sipas përcaktimeve ligjore.
7. Pas marrjes nga KPPA-JA, të vendimit për fitimin e titullit akademik, dosja e kandidatit së bashku me vendimin e KPPA-së, përcillen tek Drejtoria e Shkencës dhe Promovimit Akademik të UBT-së, për arshivim në arshivë qendrore të UBT-së.

Neni 19 **Përsëritja e kërkesës për fitimin e titujve akademikë**

Në rast refuzimi të kërkesës për fitimin e titujve akademikë nga Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik (KPPA), ose dhe Rektori, kandidatit i lind e drejta të ripërsërisë kërkesën, pas një periudhe kohore jo më të shkurtër se 2 (dy) vite nga data e paraqitjes së kërkesës së mëparshme.



Neni 20

Regjistrimi i titullit akademik

1. Titulli akademik regjistrohet në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë dhe në regjistrin e gradave shkencore dhe titujve akademikë të Universitetit Bujqësor të Tiranës.
2. Titulli akademik lëshohet nga institucioni dhe nënshkruhet nga Rektori, brenda **10 (dhjetë) ditëve** nga data e dhënies së vendimit përfundimtar nga Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik.

Neni 21

Revokimi i titujve akademikë

Rektori merr vendimin për revokimin e titujve akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor”, në rastet kur vërtetohet plagjatura ose manipulimi i të dhënave në punimet e kandidatit.

KREU V

TITUJ PËR KONTRIBUT TË VEÇANTË

Neni 22

Titulli "*Doctor Honoris Causa*"

1. Universiteti Bujqësor i Tiranës mund të akordojë titullin "*Doctor Honoris Causa*" për figura të shquara të shkencës e shoqërisë, brenda dhe jashtë vendit, për kontribut të veçantë në zhvillimin e arsimit të shkencës, si dhe në zhvillimin e vendit tonë në tërësi. Ky titull jepet me vendim të Senatit Akademik, pasi merret pëlqimi i ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë.
2. Numri i titujve "*Doctor Honoris Causa*" nuk mund të jetë më shumë se 3(tre) në vit, përjashtuar raste të veçanta të konsideruara nga Senati Akademik.

Neni 23

Titulli "*Profesor emeritus*"

1. Personelit akademik që mban titullin "Profesor", pas daljes në pension, në vlerësim të veprimtarisë së spikatur akademike, me propozim të njesisë bazë ku ka zhvilluar karrierën e tij dhe me vendim të Senatit Akademik të UBT-së i akordohet titulli "*Profesor emeritus*".
2. Titulli "*Profesor emeritus*" ju jepet profesorëve në pension, të cilët kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm në drejtim të veprimtarisë akademike, duke përfshirë dhe arritjet e dedikuara në fushën përkatëse të kerkimit shkencor.
3. Titulli i nderit "*Profesor emeritus*" i jepet personelit akademik, që plotëson kriterin e përgjithshëm të mbajtjes së titullit "Profesor" të paktën 15 vjet.
4. "*Profesori emeritus*" nuk mund të jenë punonjës efektivë të universitetit. Nëse "*Profesori emeritus*", për arsye apo nevoja të ndryshme të universitetit, mbahet ose kthehet në punë, atëherë ai trajtohet financiarisht si personel akademik "Profesor".



- Numri i titujve "Profesor emeritus" nuk mund të jetë me shumë se 3 (tre) në vit, përjashtuar raste të veçanta të konsideruara nga Senati Akademik.

Neni 24

Procedura e aprovimit të titullit "*Profesor emeritus*"

- Njësia kryesore me pëlqimin e kandidatit, rekomandon dhënien e titullit "*Profesor emeritus*", bazuar në veprimtarinë akademiko-shkencore dhe në kriteret e lartëpërmendura.
- Nëse njësia bazë vendos të bëjë rekomandimin, ky do të behet me shkrim te drejtuesi i njësisë kryesore, duke bashkëngjitur një kopje të *Curriculum vitae* si dhe veprimtari të tjera si më poshtë:
 - relacion mbi performancën e mësimdhënies dhe punën e tij krijuese nga njësia kryesore ose bazë, ku ai ka ushtruar veprimtarinë si personel akademik;
 - relacione mbi rezultatet e punës mësimore dhe kerkimore, dëshmi kualifikimesh, brenda dhe jashtë shtetit, bursa kualifikimesh e bashkëpunimesh me institucione të huaja, realizime projektesh të përbashkëta, certifikata referimesh dhe pjesëmarrjesh në konferenca dhe veprimtari të tjera;
 - rekomandime nga institucione homologe, dikastere, qendra studimore dhe eksperimentale, nga agrobiznesi, borde pedagogjike dhe studentore.
- Dekanati i njësisë kryesore shqyrton propozimin e njësisë bazë, dhe bashkë me dokumentat e lartëpërmendura përcjell zyrtarisht opinionin e tij mbi rekomandimin për titullin drejtuar Zv/Rektorit për Shkencën dhe Projektet.
- Zv/Rektori për Shkencën dhe Projektet gjykon veprimtarinë e profesorit dhe përputhshmërinë ligjore të dosjes dhe ja përcjell rekomandimin për miratimin e titullit Senatit Akademik.
- Senati Akademik do të miratojë rekomandimin dhe do të marrë vendimin për dhënien e titullit akademik "*Profesor emeritus*".
- Vendimi i Senatit firmoset nga Kryetari i Senatit dhe i përcillet Drejtorisë së Shkencës dhe Promovimit Akademik për regjistrim në regjistrin shtetëror të gradave dhe titujve pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë si dhe në regjistrin e UBT-së.
- Pas regjistrimit, Drejtoria e Shkencës dhe Promovimit Akademik, përgatit formatin, të cilin e firmos Kryetari i Senatit dhe në një ceremoni të caktuar bëhet dorëzimi i titullit "*Profesor emeritus*" nga ana e Rektorit të UBT.

Neni 25

Të drejtat e mbajtësit të titullit "*Profesor emeritus*"

- Me marrjen e titullit, "*Profesor emeritus*" profesori ka të drejtë të qëndrojë pranë departamentit për një periudhë deri në moshën 70 vjet dhe të ketë një zyrë, ose pjesë të saj, me të gjitha të drejtat morale të stafit akademik të punësuar.
- "*Profesor emeritus*" mund të bëjë kërkime brenda fushave të njësisë bazë, të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet shkencore dhe debatet akademike.
- "*Profesor emeritus*" me marrjen e titullit duhet të pranojë dhe të respektojë politikat e universitetit në lidhje me informacionin konfidencial dhe mbrojtjen e të dhënave, etj.
- Personeli akademik në pension, i cili ka fituar titullin "*Profesor emeritus*" mund ta përfshijë titullin në botime dhe nënshkrime në emër të universitetit si për shembull "*Profesor emeritus*" i UBT-së.



5. Në mënyrë të ngjashme, universiteti mund të përfshijë emrat e personave akademike që mbajnë titullin "*Profesor emeritus*" në botime, në faqet e departamenteve, në materiale të ndryshme marketingu, etj.
6. Ai duhet të mbështesë universitetin duke u angazhuar si vullnetar në një sërë aktivitete (si për shembull: ofrimin e ligjëratave si i ftuar, si mentor për stafin e ri akademik, të japë ndihmën për shkrimin e propozimeve, metodikave, etj.).
7. *Profesori emeritus* mund të luajë një rol mbështetës në mbikqyrjen e studentëve të doktoratës, por sidoqoftë ai nuk mund të jetë supervisor (udhëheqës) parësor.
8. Profesorit Emeritus në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me atë të UBT-së, i krijohen dhe gëzon disa lehtësira dhe përparësi të tilla si: përdorimi i bibliotekës së universitetit, përdorimi i aseteve të ndryshme, përdorimi i infrastrukturës laboratorike, parcelave eksperimentale, mjeteve të komunikimit, pjesëmarrjes në ngjarjet festive dhe ceremoniale të universitetit, të drejtën për të aplikuar për kontrata dhe grante nën siglën e departamentit, fakultetit apo dhe universitetit sipas rrethanave, etj.

KREU VI

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KOMISIONIT TE PROMOVIMIT TE PERSONELIT AKADEMIK (KPPA)

Neni 26

Organi përgjegjës për dhënien e titujve akademikë

Organi përgjegjës për dhënien e titujve akademike "Profesor i asociuar" dhe "Profesor" në Universitetin Bujqësor të Tiranës është Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik (KPPA).

Neni 27

Numri dhe mandati i anëtarëve të Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik

1. Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, me përfaqësues nga çdo njësi kryesore.
2. Anëtarët e Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik (KPPA) mbajnë titullin "Profesor".
3. Anëtarët e Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik në UBT vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati Akademik për një mandat dy vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

Neni 28

Kryetari i Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik

1. Mbledhja e KPPA thirret nga Rektori mbas zbardhjes së vendimit të Senatit Akademik për zgjedhjen e anëtarëve.



2. Kandidati për Kryetar vetëkandidohet ose propozohet nga drejtuesi i mbledhjes ose pjesëmarrësit në takim.
3. Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik, zgjedh me shumicë të thjeshtë të anëtarëve Kryetarin e Komisionit.
4. Mandati i Kryetarit të Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik është 2 vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Neni 29

Detyrat e Kryetarit të Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik

Kryetari i Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik kryen këto detyra:

1. drejton mbledhjet e Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik;
2. organizon punën e Komisionit për ndjekjen dhe monitorimin, në vazhdimësi, të procesit të dhënies së titujve akademikë;
3. organizon punën për trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave në lidhje me procesin e dhënies së titujve akademikë;
4. informon në mënyrë periodike Rektorin apo zv. Rektorin për Kërkimin Shkencor dhe Projektet, për problematikat që janë konstatuar;
5. përcjell vendimet e Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik, me firmën e tij, në respekt të institucionit dhe të rregullores së përcjelljes së shkresave, brenda UBT-së.

Neni 30

Pjesëmarrja e anëtarëve në mbledhjet e Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik

1. Anëtarët e Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik marrin pjesë regullisht në të gjitha mbledhjet e komisionit, me përjashtim të rasteve kur, për arsye objektive dhe me njoftimin paraprak të Kryetarit, nuk mund të jenë të pranishëm.
2. Anëtarët e Komisionit, në kryerjen e detyrave, duhet të jenë të paanshëm dhe të shmangin konfliktet e interesit në përputhje me praktikatat më të mira ligjore.

Neni 31

Sekretari i Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik

1. Sekretar i Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik është përgjegjësi i Sektorit të Kërkimit Shkencor dhe Promovimit Akademik. Sekretari i KPPA duhet të ketë së paku gradën shkencore "Doktor".
2. Sekretari merr pjesë në të gjitha mbledhjet e Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik, duke mbajtur proces-verbalin përkatës.
3. Përgatit kushtet për mbarëvajtjen e të gjitha mbledhjeve të Komisionit: njoftimet, sallën e mbledhjeve, materialet e mbledhjeve, etj.
4. Mban dhe nënshkruan proces-verbalin e mbledhjeve, si dhe zbardh vendimet e marra, jo më vonë se dy ditë nga përfundimi i mbledhjes.
5. Administron dokumentacionin e Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkon Komisioni dhe Kryetari i tij, brenda fushës së aktivitetit.



6. Në rast mungese të tij, për arsye objektive, për një mbledhje të njoftuar, sekretari zëvendësohet nga anëtari më i ri në moshë.

Neni 32

Thirrja e mbledhjeve

1. Mbledhjet e KPPA, si rregull, thirren nga Kryetari i tij.
2. Thirrja e mbledhjeve mund të bëhet edhe me kërkesë të 1/3 së anëtarëve të KPPA, duke përcaktuar çështjet për të cilat thirret kjo mbledhje.
3. Lajmërimet për thirjen e mbledhjeve bëhen brenda 51 ditëve pas paraqitjes së kërkesës nga 1/3 e anëtarëve, por gjithsesi, të paktën 48 orë para datës së mbajtjes së mbledhjes.
4. Lajmërimi për mbledhje, bëhet me shkrim dhe/ose nëpërmjet postës elektronike dhe duhet të tregojë në mënyrë të qartë dhe të detajuar çështjet për të cilat do të diskutohet. Anëtarëve të KPPA, duhet t'ju dërgohen të gjitha materialet që do të diskutohen në mbledhje, si relacione, vlerësime, raporte, etj., në momentin e lajmërimit për mbledhje.

Neni 33

Kuorumi

1. Mbledhja e Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik është e vlefshme kur janë pranishëm 2/3 e anëtarëve të tij, ose jo më pak se 4 (katër) anëtarë, përveç rasteve kur kjo rregullore e parashikon ndryshe.
2. Kur në hapjen e mbledhjes nuk janë të pranishëm shumica e anëtarëve, Kryetari vendos thirrjen e mbledhjes në një ditë tjetër, të paktën 24 orë pas së parës.

Neni 34

Procedura e vlerësimit të dosjes së kandidatit

1. Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik vlerëson dosjen e çdo kandidati që i paraqet, njësia kryesore pranë së cilës ai ka aplikuar për marrjen e titullit akademik "Profesor i Asociuar" ose "Profesor".
2. E gjithë procedura e KPPA në lidhje me pranimin e dosjes, mënyrën e vlerësimit, ngritjen dhe miratimin e jurisë, hartimin e raportit të vlerësimit, etj, realizohet sipas përcaktimeve të bëra në nenet 17 dhe 18 të kësaj rregulloreje.

Neni 35

Votimi

1. Votimi në mbledhjet e Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik bëhet i hapur, me perjashtim të rasteve kur cilësohet ndryshe në legjislacionin në fuqi, si dhe kur kërkohet nga Kryetari apo nga një e treta e anëtarëve, të pranishëm në mbledhje.
2. Anëtarët e Komisionit, që janë të pranishëm në mbledhje dhe që nuk kanë ndonjë pengesë ligjore për të votuar, shprehin qëndrimin e tyre "pro" "kundër" ose "abstenim".
3. Kryetari i Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik voton i fundit.



Neni 36

Marrja e vendimeve

1. Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik merr vendime vetëm për çështje të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes, me përjashtim të rasteve kur të paktën 2/3 e anëtarëve të pranishëm në mbledhje, vendosin për shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve për çështje që nuk janë në rendin e ditës.
2. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të pranishëm në mbledhje, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë rregullore apo në aktet e tjera nënligjore në fuqi, në nivel kombëtar apo institucional.
3. Nëqoftëse edhe në votimin e dytë persëritet e njëjta situatë, vendimi shtyhet për t'u marrë në mbledhjen tjetër, në të cilën shumica e thjeshtë është e mjaftueshme.

Neni 37

Barazia e votave

1. Në rastet kur rezultati i votimit është i barabartë dhe votimi është i hapur, vota e Kryetarit është vendimtare.
2. Në rast se votimi bëhet i fshehtë dhe votat janë të barabarta, kryhet një votim i dytë. Kur edhe në votimin e dytë ka barazi të votave, vendimi shtyhet për mbledhjen tjetër. Në qoftëse në votimin e parë të mbledhjes tjetër ka përsëri një barazi votash, atëherë kryhet votim i hapur.

Neni 38

Proces-verbali i mbledhjes

1. Në çdo mbledhje mbahet një proces-verbal, ku bëhet një permbledhje e problematikës së mbledhjes, data dhe vendi i mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën, si dhe forma dhe rezultati i votimeve.
2. Proces-verbali mbahet nga sekretari dhe duhet t'ju paraqitet për miratim të gjithë anëtarëve në fund të mbledhjes ose në fillim të mbledhjes pasardhëse. Pas miratimit, proces-verbali nënshkruhet nga kryetari dhe sekretari.
3. Në rastet kur vetë Komisioni e shikon të arsyeshme dhe mbledhja është e ndarë në seanca, proces-verbali miratohet menjëherë pas përfundimit të seancës përkatëse.
4. Anëtarët e Komisionit mund të kërkojnë që të shënohet në proces-verbal fakti dhe arsyet e votimit kundër një vendimi të marrë nga Komisioni.

Neni 39

Zbardhja e vendimeve

1. Vendimet e Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik, zbardhen nga sekretari, jo me vonë se dy ditë nga përfundimi i mbledhjes. Ato hartohen në katër kopje, të cilat nënshkruhen nga Kryetari. Një kopje e firmosur nga Kryetari, administrohet në arkivën e institucionit, ndërsa nga tri kopjet e tjera, njëra ruhet në dosjen përkatëse të Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik dhe dy të tjerat i adresohen, njëra Rektorit të institucionit dhe tjetra kandidatit që kërkon fitimin e titullit akademik.
2. Vendimet e Komisionit publikohen, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.



Neni 40

Propozimet për ndryshimin e rregullores

Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik mund të bëjë propozime konkrete për ndryshimin e rregullores së funksionimit të tij, duke ia përcjellë Senatit të UBT-së, për miratimin përfundimtar.

Neni 41

Shpërblimi

Mënyra dhe masa e shpërblimit të Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik dhe sekretarit/sekretares së tij, miratohen nga Bordi i Administrimit, me propozimin e Senatit Akademik të UBT-së.

KREU VII

DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 42

Kriteret e Kualifikimit për Titullin Akademik 'Profesor' deri në Vitin Akademik 2026-2027

Për personelin akademik me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, që aplikon deri në fillimin e vitit akademik 2026-2027, për titullin akademik “Profesor”, kriteri i shkronjës “c”, të pikës 3, të kreut III, konsiderohet i plotësuar nëse ka udhëhequr/bashkudhëhequr, të paktën, 1 (një) doktoratë, të përfunduar.

a) Ndërsa, në rast se kandidati ushtron veprimtarinë e tij akademike shkencore pranë një njësie kryesore me më pak se 40 (dyzet) veta personel akademik me kohë të plotë, kriteri i shkronjës “c”, të pikës 3, të kreut III të VKM-se nr. 128/2024, konsiderohet i plotësuar nëse kandidati është duke udhëhequr/bashkudhëhequr, të paktën, 1 (një) doktoratë dhe duhet të përmbushë edhe një nga kushtet e mëposhtme:

- i. Të ketë pasur ose ka rolin e drejtuesit në një projekt ndërkombëtar;
- ii. Të ketë dhënë ose jep mësim në një program në gjuhë të huaj në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Evropian, anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht apo italisht;
- iii. Të ketë përfunduar me sukses së paku të gjitha detyrimet e vitit të dytë, sipas përcaktimeve në rregulloren përkatëse të programit të studimit, të doktoratës, të kandidatit doktorant që ka në udhëheqje/bashkudhëheqje të doktoratës”.

b) Kandidatët, të cilët kanë filluar procedurën për marrjen e gradës shkencore ose titujve akademikë dhe kanë kaluar fazën e miratimit nga Komisioni i Dhënies së Gradës Shkencore “Doktor” ose Komisioni i Promovimit të Personelit Akademik e mbyllin procedurën për marrjen e gradës shkencore ose titullit akademik, sipas kriterëve të legjislacionit në fuqi, në momentin e dorëzimit të dosjes pranë drejtuesit të njësisë kryesore.

Neni 43

Miratimi dhe hyrja në fuqi

Kjo rregullore miratohet me vendim të Senatit Akademik të Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe hyn në fuqi menjëherë pas miratimit.



UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS – RREGULLORE PËR FITIMIN E TITUJVE AKADEMIKË

Ngarkohen për zbatimin e kësaj rregulloreje njësitë bazë, Dekanatet e njësive kryesore, Drejtoria e Shkencës dhe Promovimit Akademik në UBT, Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik pranë Senatit Akademik (KPPA-ja), etj.

